

DHUNA NDËRMJET BASHKËMOSHATARËVE TE NXËNËSIT E MOSHËS 11, 13 DHE 15 VJEÇARE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Raport kombëtar për sjelljet lidhur
me shëndetin e fëmijëve të moshës
shkollore nga hulumtimi i vitit 2021/22
në Republikën e Maqedonisë së Veriut

**Maja Cvetanoska, Lina Qostarova-Unkovska,
Sheruze Osmani Ballazhi, Ivan Hristov**

Македонија

DHUNA NDËRMJET BASHKËMOSHATARËVE TE NXËNËSIT E MOSHËS 11, 13 DHE 15 VJEÇARE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Raport kombëtar për sjelljet lidhur me shëndetin e fëmijëve të moshës shkollore nga hulumtimi i vitit 2021/22 në Republikën e Maqedonisë së Veriut

**Maja Cvetanoska, Lina Qostarova-Unkovska,
Sheruze Osmani Ballazhi, Ivan Hristov**

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

316.624-057.874:364.63"2021-2022"(497.7)(047.31)
364.63-057.874"2021-2022"(497.7)(047.31)

DHUNA ndërmjet bashkëmoshatarëve te nxënësit e moshës 11, 13 dhe 15 vjeçare në Republikën e Maqedonisë së Veriut : Raport kombëtar për sjelljet lidhur me shëndetin e fëmijëve të moshës shkollore nga hulumtimi i vitit 2021/22 në Republikën e Maqedonisë së Veriut / Maja Cvetanoska,...[и др.] ; [përkthimi Behare Kasami]. - Shkup : Qendra për veprim psiko-social dhe të krizës -Malinska, 2025. - 31 стр. : табели, граф. прикази ; 21 см

Фусноти кон текстот. - Останати автори: Lina Qostarova-Unkovska, Sheruze Osmani Ballazhi, Ivan Hristov. - Библиографија: стр. 29-30

ISBN 978-9989-9544-8-1

1. Cvetanoska, Maja [автор] 2. Qostarova-Unkovska, Lina [автор] 3. Osmani Ballazhi, Sheruze [автор] 4. Hristov, Ivan [автор]
а) Врсничко насилство -- Социјална интеракција -- Ученици -- Македонија -- 2021, 2022 -- Извештаи б) Булинг -- Мобинг -- Ученици -- Македонија -- 2021, 2022 -- Извештаи

COBISS.MK-ID 65688837



Ky publikim është përgatitur me mbështetjen e UNFPA-së, Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë. Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UNFPA-së, Kombeve të Bashkuara ose ndonjë organizate tjetër të lidhur.

Abstrakt

Studimi për sjelljet e lidhura me shëndetin e fëmijëve në moshën shkollore (HBSC) është studim ndërkombëtar dhe longitudinal, i cili kryhet çdo katër vjet, në bashkëpunim me Zyrën Rajonale për Evropën të Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, studimin e zbaton Qendra për Veprim Psiko-Social dhe të Krizës – Malinska, me miratim të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Byrosë për zhvillim të arsimit së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe **në bashkëpunim me Fondin për Popullsi të Kombeve të Bashkuara** – UNFPA. Hulumtimi kryhet me një mostër përfaqësuese kombëtare, në shkolla me mësim në gjuhën maqedonase dhe shqipe. Gjetjet e hulumtimit janë të disponueshme për përdorim në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, për të mundësuar kuptim më të mirë të shëndetit dhe mirëqenies së adoleshentëve dhe përcaktuesve socialë të shëndetit, me qëllim krijimin e politikave të informuara, ndërhyrjeve dhe praktikave që rrisin cilësinë e jetës së të rinjve.

Ky raport është i pari nga raportet kombëtare për hulumtimin në vitin 2021/22, në të cilin paraqiten gjetjet për dhunën ndërmjet bashkëmoshatarëve (ngacmimet në shkollë, ngacmimet kibernetike dhe përlëshjet), roli i gjinisë, pabarazitë sociale dhe ndryshimet në sjelljet e lidhura me ngacmimet dhe përlëshjet gjatë periudhave para dhe pas pandemisë me Kovid-19. Në këtë raport janë paraqitur edhe disa nga gjetjet lidhur me dhunën e përjetuar nga adoleshentët që kanë deklaruar se ngacmojnë të tjerët, me qëllim që të kuptohet cikli i dhunës që vazhdon të ekzistojë në familje dhe bashkësi.

Raportin e shqyrtuan: Kalina Sotiroska Ivanoska, Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi”, Shkup; Luljeta Bexheti, Universiteti i Tetovës; Ibrahim Neziri, Universiteti i Tetovës; dhe Ana Poprizova, SHMQSH “Orce Nikolov”, Shkup.

Fjalët kyçe: STATUSI SHËNDETSOR, PABARAZI, ADOLESHENTË, NGACMIM, NGACMIM KIBERNETIK, PËRLESHJE, DHUNË

Mënyra e citimit: Cvetanoska M, Qostarova-Unkovska L, Osmani Ballazhi Sh, Hristov I. Dhuna ndërmjet bashkëmoshatarëve te nxënësit e moshës 11, 13 dhe 15 vjeçare në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Raporti Kombëtar për sjelljet lidhur me shëndetin e fëmijëve të moshës shkollore nga hulumtimi i vitit 2021/22 në Republikën e Maqedonisë së Veriut. 2024. Malinska, Shkup.

Mënyra e qasjes (URL): <https://northmacedonia.unfpa.org/en>

ISBN 978-9989-9544-8-1

Dizajn: Elena Dimanovska

Përkthimi: Behare Kasami

Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

Përmbajtje

Falënderime	3
Hyrje	5
Dhuna ndërmjet bashkëmoshatarëve në adoleshencën e hershme	5
Sfondi i sjelljes së dhunshme te nxënësit e moshave 11, 13 dhe 15 vjeç në vendin tonë	6
Konteksti hulumtues dhe matjet	8
Matja për dhunën ndërmjet bashkëmoshatarëve dhe përvojat me dhunë ndaj fëmijëve	8
Gjetjet	11
Gjetjet për llojet e dhunës ndërmjet bashkëmoshatarëve	11
Nxënësit që janë ngacmuar në shkollë	11
Nxënësit që kanë ngacmuar të tjerët në shkollë	12
Nxënësit që kanë përjetuar ngacmim kibernetik	13
Nxënësit që kanë marrë pjesë në ngacmim kibernetik	13
Nxënësit që kanë marrë pjesë në përleshje	14
Gjetje për përvojat me dhunën ndaj fëmijëve	15
Nxënësit që janë keqtrajtuar fizikisht	15
Nxënësit që janë keqtrajtuar emocionalisht	16
Nxënësit që janë keqtrajtuar seksualisht	16
Nxënësit që kanë qenë dëshmitarë të dhunës në familje	17
Tendencat themelore	19
Dallimet gjinore	19
Ndikimi i moshës	19
Ndryshimet me kalimin e kohës – para dhe pas Kovid-it	20
Përfundime	23
Rekomandime	25
Shembuj të praktikave të mira për parandalimin e dhunës ndërmjet bashkëmoshatarëve	27
Shembull nga vendi ynë	27
Shembuj nga vende të tjera	27
Programi Olweus	27
Programi KiVa	27
Literatura e përdorur	29

Falënderime

Hulumtimi ndërkombëtar për vitin 2021/2022 u drejtua nga Qendra ndërkombëtare koordinative e HBSC, pranë Universitetit të Glasgouit, në Glasgou, Mbretëri e Bashkuar (Skoci), nën udhëheqjen e Xho Inçli, koordinator i studimit HBSC. Të dhënat u menaxhuan, pastruan dhe u përgatitën për përdorim nga Qendra për menaxhimin e bankave të të dhënave (Databank Management Centre), Universiteti i Bergenit, në Bergen, Norvegji, e drejtuar nga Oddrun Samdal.

Hulumtimi kombëtar u realizua në bashkëpunim nën udhëheqjen e Lina Qostarova-Unkovska, hulumtuese kryesore, me anëtarët e ekipit hulumtues: Kalina Sotiroska Ivanoska, Sheruze Osmani Ballazhi, Luljeta Bexheti, Ibrahim Neziri, Ana Poprizova, Ivan Hristov dhe Maja Cvetanoska, në bashkëpunim me ekipin e koordinatorëve rajonalë: Behare Kasami, Vesna Terzioska, Irena Donçevska, Liljana Arsova, Renata Dedova, Sara Osmani, Safet Ballazhi dhe Snezana Uzunova. Për kryerjen e hulumtimit në shkolla ishin përgjegjës 148 koordinatorë shkollash nga 141 shkolla fillore dhe të mesme nga të tetë rajonet e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me paralele në gjuhën maqedonase dhe shqipe.

Ekipi kombëtar falënderon drejtuesit e shkollave, ekipet profesionale në shkolla, nxënësit dhe prindërit për pjesëmarrjen e tyre të përkushtuar në këtë cikël hulumtimi.

Falënderime të veçanta i drejtojmë Universitetit të Tetovës për krijimin e platformës online për mbledhjen e parë elektronike të të dhënave brenda këtij cikli hulumtimi, si dhe për sigurimin e cilësisë së lartë gjatë gjithë procesit, të drejtuar nga Ibrahim Neziri.


Jemi mirënjohës për studentët vullnetarë të Universitetit të Tetovës, të cilët ndihmuan në realizimin e pjesës në terren të hulumtimit: Albana Uzairi, Arbnora Shabani, Bardha Izairi, Valmira Sejдини, Lirie Aliti, Medina Imeri dhe Fatime Zulquliu.

Falënderime i drejtojmë gjithashtu mbështetësve të ciklit të fundit të hulumtimit, të cilët me njohuritë, punën dhe kohën e tyre kontribuan në realizimin e suksesshëm të tij: Stefan Qostarov për dizajnimin dhe përgatitjen për shtyp të pyetësorëve, Behare Kasami për përkthimin dhe redaktimin e pyetësorëve në gjuhën shqipe, Ljubinka Brashnarska dhe Zlata Gjuroska Brajoviq për përkthimin dhe redaktimin e përkthimit në gjuhën maqedonase dhe angleze, si dhe Violeta Karaxhovska për redaktimin e pyetësorëve në gjuhën maqedonase.

Falënderojmë gjithashtu prof. Elizabeta Gjorgievska, bashkëshorten e ish-Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për mbështetjen e vazhdueshme në promovimin e Studimit HBSC, si dhe Fakultetet e Filozofisë pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup dhe Universitetit të Tetovës, për mbështetjen e tyre në ndarjen e rezultateve të këtij cikli hulumtimi me komunitetin akademik dhe profesional në vend.

Studimi HBSC u realizua me miratimin dhe mbështetjen e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Byrosë për Zhvillimin e Arsimit.

Mbështetja financiare për këtë publikim u siguroi nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë.



Hyrje

Në fund të shekullit të kaluar, dhuna u shpall si një problem i madh shëndetësor, dhe me këtë edhe dhuna ndaj fëmijëve, nga një temë nën hije, ngadalë filloi të bëhet e dukshme përmes shifrave dhe dëshmive në nivel global (1). Ndërlikueshmëria dhe tradita e gjatë e dhunës si temë tabu i bën ndryshimet shumë të vështira dhe të ngadalshme, kështu që edhe pas gati tri dekadash, gjetjet globale tregojnë një gjendje serioze të shëndetit të fëmijëve dhe të rinjve për shkak të ekspozimit të tyre ndaj formave të ndryshme të dhunës. Premtimi për një botë pa dhunë deri në vitin 2030 është sfida e madhe, për të cilën është i nevojshëm angazhimi i plotë i bashkësisë, në nivel lokal dhe global, pasi të dhënat akoma tregojnë se çdo i dyti fëmijë në botë përjeton ndonjë formë të dhunës dhe pothuajse çdo i treti nxënës në botë është ngacmuar nga bashkëmoshatarët të paktën një herë gjatë muajit të fundit (2).

Hulumtimet aktuale në vendin tonë (3, 4) tregojnë se varfëria, pabarazia gjinore dhe kultura tradicionale ende mbështesin dhunën ndaj fëmijëve edhe në ditët e sotme. Shumica e prindërve në mjedisin tonë besojnë se metodat e dhunshme funksionojnë, se dënimi është shpesh masë e justifikuar edukative dhe se fëmijët nuk duhet t'u kundërvihen të rriturve. E gjithë kjo është e mbështetur nga përvojat personale nga fëmijëria dhe normat shoqërore ose kuptimi se shumica e “bën këtë” dhe se “nuk dënohet” nga të tjerët.

Rekomandimet për çrrënjosjen e dhunës, që dalin nga analizat globale (5), ndër të tjera flasin për nevojën që shtetet të kenë evidencë për kategoritë e cenueshme të fëmijëve, për dimensionin gjinor, për progresin në drejtim të parandalimit të dhunës, si dhe për rëndësinë thelbësore të përfshirjes së fëmijëve në proceset për përballje me dhunën.

“Rekomandoj që shtetet t'i përfshijnë aktivisht fëmijët dhe t'i respektojnë qëndrimet e tyre në të gjitha aspektet e parandalimit, përgjigjes ndaj dhunës dhe monitorimit të dhunës ndaj tyre, duke marrë parasysh nenin 12 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës. Duhet të mbështeten dhe inkurajohen organizatat për fëmijët dhe iniciativat për përballje me dhunën të udhëhequra nga fëmijët, që janë në interesin më të mirë të fëmijës.” – Paulo Sérgio Pinheiro, ekspert i pavarur për Studimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për dhunën ndaj fëmijëve.

Ky rekomandim i fuqishëm është ende larg realizimit të qenësishëm në vendin tonë, ku fëmijët janë në shkallën më të ulët të pushtetit dhe pjesëmarrjes në jetën familjare, shkollore dhe shoqërore. Edhe përkundër angazhimeve strategjike dhe detyrimeve ligjore që zëri i fëmijës të dëgjohej, praktika tregon se kur fëmijët përballen me sfida, si për shembull dhunë ndërmjet bashkëmoshatarëve, nuk ka kush t'i dëgjojë.

Dhuna ndërmjet bashkëmoshatarëve në adoleshencën e hershme

Adoleshenca është periudha më komplekse e zhvillimit në jetë, e karakterizuar nga një shumëllojshmëri dhe dinamikë e madhe ndryshimesh në të gjitha fushat e zhvillimit të fëmijës, por edhe nga kapaciteti i jashtëzakonshëm për të shqyrtuar dhe riformuluar perspektivat, qëndrimet dhe vlerat ekzistuese, të cilat ndikojnë fuqishëm në sjelljen e tij aktuale, por edhe në rezultatet përfundimtare për shëndetin dhe mirëqenien e të rriturit në të ardhmen (8).

Fëmijët në adoleshencën e hershme përballen me sfida të shumta, për të cilat shpesh nuk marrin përgjigje, ndër të cilat shpesh është dhuna, siç janë zënkat, si dhe forma të ndryshme të ngacmimeve dhe keqpërdorimit. Kohët e fundit, ngacmimi kibernetik është gjithashtu në rritje, veçanërisht i përforcuar me fillimin e pandemisë së virusit Kovid-19, kur teknologjia dhe mediat sociale u bënë mjetet dominante për komunikim dhe arsimim (6).

Ngacmimi, si një nga format e dhunës, ndodh në shkollë dhe jashtë saj, si dhe online, në rrjetet sociale. Viteve të fundit, është folur gjithnjë e më hapur për këtë formë të dhunës ndërmjet bashkëmoshatarëve, shkollat janë përfshirë në programe për njohjen dhe parandalimin e saj, por pavarësisht kësaj, prindërit dhe personeli i shkollës nuk kanë njohuri të mjaftueshme për sfondin dhe ndërlikueshmërinë e kësaj dukurie, dhe as kompetenca të mjaftueshme për t'iu përgjigjur në mënyrë të përshtatshme dhe për ta parandaluar dhunën në shkollë (3, 9). Në kushtet e këtilla, më së shpeshti rrethi i dhunës vazhdon të ushqehet dhe nxit përjashtimin dhe izolimin e fëmijëve dhe të rinjve që etiketohen si “dhunues”, në vend të përfshirjes dhe lidhjes së tyre me bashkëmoshatarët dhe të rriturit e rëndësishëm.

Sfondi i sjelljes së dhunshme te nxënësit e moshave 11, 13 dhe 15 vjeç në vendin tonë

Adoleshentët që janë të prekur nga dhuna – si ata që e ushtrojnë, ashtu edhe ata që janë viktimë të dhunës – janë në rrezik të madh për shëndetin e tyre mendor dhe fizik (5). Për të punuar në drejtim të ndërprerjes së ciklit të dhunës, është e nevojshme të shqyrtojmë sfondin e sjelljes së dhunshme të fëmijëve dhe të rinjve që kryejnë ngacmime dhe ngacmime kibernetike, të cilët janë në rrezik për shëndetin e tyre mendor (7). Është thelbësore të kuptojmë përvojat e tyre të hershme si viktimë të dhunës dhe keqpërdorimit, si dhe të shohim mbështetjes e zvogëluar nga personat e tyre të rëndësishëm, për të pasur një bazë të fortë për planifikimin e programeve të parandalimit dhe ndërhyrjeve të përshtatura për nevojat dhe të drejtat e kësaj kategorie të cenueshme të adoleshentëve (14).

Gjetjet nga Studimi i HBSC-së tregojnë për një cenueshmëri më të lartë te fëmijët që kanë raportuar pjesëmarrje në ngacmimin e të tjerëve, krahasuar me bashkëmoshatarët e tyre, në disa tregues (7). Për shembull, këta fëmijë shfaqin më shumë vështirësi psikosomatike dhe depresion krahasuar me bashkëmoshatarët e tyre që nuk kanë raportuar pjesëmarrje në ngacmimin e të tjerëve, dhe ndër më të cenueshmet janë vajzat e moshës 15 vjeçare. Një nga 10 fëmijë mes tyre ndihet gjithmonë i vetmuar.

Për më tepër, fëmijët që kanë deklaruar se kryejnë ngacmime kanë kapacitete më të ulëta për t'u përballur me sfidat e jetës krahasuar me bashkëmoshatarët e tyre, gjegjësisht ata e përjetojnë më shpesh jetën si të paparashikueshme, pa kontroll dhe me ndjesi të përshkimit nga problemet jetësore; ata shfaqin mirëqenie mendore të ulët, rrezik të shtuar nga depresioni dhe kanë kapacitete emocionale më të ulëta (përjetimi dhe sjellja ndaj ndjenjave të veta dhe të të tjerëve) (7).

Në prapavijë qëndron përvoja e tyre me dhunën fizike dhe psikologjike në shtëpi, dhuna seksuale, neglizhimi, mungesa e kujdesit nga një i rritur, dhe shumë prej tyre kanë qenë dëshmitar të dhunës në shtëpi (7).

Gjithashtu, këta fëmijë ndiejnë më pak mbështetje nga bashkëmoshatarët, mësuesit dhe prindërit e tyre, si dhe kanë lidhshmëri më të dobët me shkollën (7).

Gjetjet kryesore për dhunën ndërmjet bashkëmoshatarëve në nivel ndërkombëtar tregojnë për ndryshime të mëdha në fushën e ndërveprimeve të adoleshentëve, si dhe në rritjen e komunikimeve elektronike në krahasim me ato të drejtpërdrejta, duke rritur kështu rreziqet e dhunës kibernetike, në krahasim me dhunën tradicionale midis moshatarëve (6). Megjithatë, të gjitha format e tjera të dhunës ndërmjet bashkëmoshatarëve, si dhe lidhshmëria e tyre me kontekstin dhe kulturën e bashkësisë ku fëmijët mësojnë dhe rriten, kërkojnë vëmendje të plotë dhe gjithëpërfshirëse.

Ky raport ka për qëllim të informojë dhe të kontribuojë për një kuptim më të mirë të sjelljes së dhunshme, si dhe të faktorëve të lidhur me dhunën midis të rinjve. Njëkohësisht, ai mund të shërbejë edhe si një drejtim për ndërtimin e mjediseve më të sigurta shkollore, ku çdo fëmijë është i vërejtur dhe i mbështetur në zhvillimin e tij.

Konteksti hulumtues dhe matjet

Një nga kanalet më konsistente të hapura për zërin e fëmijëve dhe të rinjve të ne është përfshirja e tyre në më shumë aktivitete hulumtimi dhe komunikimi brenda Studimit të HBSC-së për sjelljet lidhur me shëndetin e fëmijëve të moshës shkollore (11–15 vjeç)¹. Ky studim longitudinal, bashkëpunues i Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) kryhet në më shumë se 50 vende të Evropës, Kanadasë dhe Azisë gjatë 40 viteve të fundit, ndërsa në 20 vitet e fundit edhe në vendin tonë².

Studimi bazohet në teori pozitive sociologjike dhe psikologjike për shëndetin si burim dhe cilësi e jetës, si një tërësi e shëndetit fizik, mendor, social dhe shpirtëror, përkundër modelit mjekësor, sipas të cilit shëndeti shihet si mungesë e sëmundjes. Modeli bio-ekologjik i shëndetit, mbi të cilin mbështetet Studimi, është një kornizë konceptuale për të kuptuar lidhjen e individit me mikro dhe makromjedisin dhe ndërveprimin e tyre në avancimin e shëndetit dhe mirëqenies së individit dhe bashkësisë.

Qëllimi i studimit është të sigurojë një vështrim mbi gjendjet aktuale të shëndetit të fëmijëve në të gjitha format e tij, në rrethana konkrete jetësore, të ndjekura në mënyrë krahasuese në kontekste të ndryshme me vende dhe kultura të tjera, si dhe të ndjekura gjatë periudhave më të gjata kohore, në cikle katërvjeçare.

Hulumtimi kryhet duke përdorur një protokoll të rreptë për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, i cili garanton anonimitetin e çdo fëmije. Instrumentet e përdorura në hulumtim janë të grupuara në 1) pyetësor i detyrueshëm për të gjitha vendet dhe 2) disa pyetësorë opsionalë me tema interesi për secilin vend.

Gjetjet janë prezantuar në dy grupe: 1) gjetje për të tri format e dhunës ndërmjet bashkëmoshatarëve – ngacmimi i drejtpërdrejtë, ngacmimi kibernetik dhe pjesëmarrja në përleshje; dhe 2) gjetje për përvojat e fëmijëve që ngacmojnë bashkëmoshatarët e tjerë. Janë përshkruar gjithashtu edhe matjet për secilin prej këtyre indikatorëve.

Matja për dhunën ndërmjet bashkëmoshatarëve dhe përvojat me dhunë ndaj fëmijëve

Ngacmimi shkollor (bullying), i cili përfshin sjellje negative, armiqësore fizike ose verbale, që përsëriten për një periudhë kohore dhe shkaktojnë shqetësim te viktimat, ndërsa nënkupton dallim në pushtet midis ngacmuesit dhe viktimës (10, 11). Ngacmimi dallon nga format e tjera të dhunës pikërisht për këto tri karakteristika: ka për qëllim t'i shkaktojë dëm një personi tjetër, ekziston një pabarazi në pozitat e pushtetit dhe dëmtimi përsëritet.

¹ <https://hbcs.org/>

<https://hbcmacedonia.wordpress.com/>

² I themeluar në vitin 1983 nga studiues nga tre vende, si një hulumtim ndërkombëtar i pavarur, me një numër në rritje të vendeve, duke përfshirë edhe Republikën e Maqedonisë së Veriut, si anëtare me të drejta të plota që nga viti 2002. HBSC është një studim sociologjik longitudinal me një qasje gjithëpërfshirëse ndaj shëndetit dhe faktorëve që ndikojnë në shprehjet dhe sjelljet shëndetësore, përkundër studimeve epidemiologjike. Realizohet çdo katër vjet, në një mostër kombëtare të nxënësve të moshave 11, 13 dhe 15 vjeç, në një numër gjithnjë në rritje të vendeve nga Evropa, Amerika e Veriut, Kanadaja dhe të tjera.

Llojet e ngacmimit shkollor janë përfshirë me pyetje që kanë të bëjnë me shpeshësinë e shtatë llojeve të ndryshme të ngacmimit shkollor dhe viktimizimit, përfshirë edhe thirrjen me emra ofendues, përjashtimin e qëllimshëm, ngacmimin fizik, ngacmimin mbi baza racore ose fetare, si dhe shakatë seksuale. Këto pyetje bazohen në instrumentin original kërkimor të Olveus (12).

Ngacmimi kibernetik është sjellje e qëllimshme që ka për qëllim ta dëmtojë një person tjetër duke shpërndarë foto, video ose artikuj konfidencialë përmes kompjuterëve, telefonave celularë dhe pajisjeve të tjera elektronike, pa pëlqimin ose dijeninë e viktimës, me qëllim përcçmimi, talljeje dhe turpërimi (13).

Pjesëmarrja në përlëshje është pjesë e një spektri të gjerë të sjelljeve të rrezikshme që ndikojnë seriozisht në shëndet, siç konfirmojnë raportet për probleme negative fizike dhe emocionale të shëndetit tek të rinjtë që janë ekspozuar ndaj përvovave të dhunshme. Përlëshjet fizike shpesh lidhen edhe me përdorimin e drogës dhe sjellje të tjera problematike, si shitja e drogës, vjedhja dhe mbajtja e armëve.

MATJA	PYETJET
Matja për të ngacmuarin/ën	Të rinjtë u pyetën se sa shpesh janë ngacmuar nga bashkëmoshatar/ë të tjerë në shkollë gjatë muajve të fundit, me mundësi përgjigjeje nga kurrë deri në disa herë në javë. Në këtë raport janë paraqitur përgjigjet për të paktën 2-3 herë gjatë muajve të fundit.
Matja për ngacmimin e të tjerëve	Të rinjtë u pyetën se sa shpesh kanë marrë pjesë në ngacmimin e bashkëmoshatar/ëve të tjerë në shkollë gjatë muajve të fundit, me mundësi përgjigjeje nga kurrë deri në disa herë në javë. Në këtë raport janë paraqitur përgjigjet për të paktën 2-3 herë gjatë muajve të fundit.
Matja për llojet e ngacmimit	Të rinjtë u pyetën se sa shpesh janë ngacmuar nga bashkëmoshatar/ë të tjerë në shkollë gjatë muajve të fundit, në mënyrat e mëposhtme: përhapja e thashethemeve dhe gënjeshtreve, thirrja me emra ofendues, përjashtimi i qëllimshëm, dhuna fizike (goditje, shtytje), etj. Mundësitë e përgjigjes variojnë nga kurrë deri disa herë në javë. Në këtë raport janë paraqitur përgjigjet për të paktën 2-3 herë gjatë muajve të fundit.
Matja për viktimën e ngacmimit kibernetik	Të rinjtë u pyetën nëse dikush u ka dërguar mesazhe të këqija të menjëhershme, postime në mur ose e-mail, ose kanë publikuar ose shpërndarë foto ose video në internet pa leje gjatë muajve të fundit, me mundësi përgjigjeje nga kurrë deri disa herë në javë. Në këtë raport janë paraqitur përgjigjet për “të paktën një ose dy herë gjatë muajve të fundit”, për të pasqyruar çfarëdo lloj viktimizimi.

Matja për ngacmimin kibernetik të të tjerëve	Të rinjtë u pyetën nëse kanë marrë pjesë në dërgimin e mesazheve të këqija të menjëhershme, postime në mur ose e-mail, ose kanë publikuar ose shpërndarë foto ose video në internet pa leje gjatë muajve të fundit, me mundësi përgjigjeje nga kurrë deri disa herë në javë. Në këtë raport janë paraqitur përgjigjet për “të paktën një ose dy herë gjatë muajve të fundit.”
Matja për pjesëmarrje në përleshje	Të rinjtë u pyetën se sa herë gjatë 12 muajve të fundit janë përfshirë në përleshje fizike, me mundësi përgjigjeje që variojnë nga asnjëherë deri në katër herë ose më shumë. Këtu janë paraqitur përgjigjet për “tri ose më shumë herë gjatë vitit të fundit”, ku përleshja trajtohet si një model i mësuar i sjelljes së përsëritur.
Matjet për përvojat me dhunën ndaj fëmijëve	Pyetësi për ngacmimin e fëmijëve përqendrohet në ngacmimin e fëmijëve dhe mat vetëm aktin e dhunës ndaj fëmijës nga ata që janë në pozita të pushtetit ose besimit dhe përfshin dhunë fizike, emocionale dhe seksuale. Për shembull, “A të ka goditur, rrahur, shkelmuar ose tentuar të të lëndojë fizikisht në ndonjë mënyrë prindi ose një i rritur tjetër në amvisëri?”. Përgjigjet variojnë nga 1 “kurrë” deri në 3 “shumë herë”. Në këtë raport paraqiten gjetjet për frekuencën “një deri dy herë në jetë”. Të qenit dëshmitar i dhunës në familje matet me pyetjen “A ke parë ose dëgjuar ndonjëherë prindin/kujdestarin tënd të jetë goditur, rrahur, shkelmuar, ose lënduar qëllimisht nga partneri/partnerja (burri/gruaja) ose ish-partneri/partnerja?”, me përgjigje që variojnë nga 1 “kurrë” deri në 3 “shumë herë”. Në këtë raport paraqiten gjetjet për frekuencën “një deri dy herë në jetë”.

Gjetjet

Gjetjet për llojet e dhunës ndërmjet bashkëmoshatarëve


Gjetjet lidhur me dhunën ndërmjet bashkëmoshatarëve paraqiten veçmas për secilën formë të saj, si nga aspekti i atyre që përjetojnë dhunë, të ashtuquajturat viktimë, ashtu edhe nga aspekti i atyre që ushtrojnë dhunë, të ashtuquajturit dhunues³.

Nxënësit që janë ngacmuar në shkollë

Gjetjet nga 44 vende, në mesatare tregojnë se 11% e adoleshentëve të moshës 11 deri në 15 vjeç janë ngacmuar në shkollë të paktën 2-3 herë në muaj gjatë muajve të fundit, pa dallime të rëndësishme gjinore.

Përqindja e ngacmimit në shkollat maqedonase (10%), të paktën 2-3 herë në muaj gjatë muajve të fundit, sillet rreth mesatares ndërkombëtare, me dallime të papërfillshme gjinore, përveç te nxënësit 11 vjeçarë. Ndërkohë, dallime të rëndësishme vërehen midis dy bashkësive më të mëdha etnike në Maqedoninë e Veriut, maqedonase dhe shqiptare, ku nxënësit në shkollat me gjuhë mësimore shqipe janë dy herë më shpesh viktimë të ngacmimit (15%) në krahasim me nxënësit maqedonas (8%). Në veçanti, 17% e vajzave shqiptare 11 vjeç, 14% të moshës 13 vjeç dhe 15% të moshës 15 vjeç raportojnë ngacmim në shkollë, të paktën dy deri në tre herë në muaj gjatë muajve të fundit. Në këtë pasqyrë të ngacmimit, kryesojnë djemtë 11 vjeç nga bashkësia etnike shqiptare me një përqindje prej 21%, që është dyfish më e lartë se mesatarja kombëtare.

Ka dallime të rëndësishme gjinore te djemtë dhe vajzat 11-vjeçare⁴ ndërkohë që pasuria familjare e fëmijëve nuk luan një rol të rëndësishëm në shkallën e ngacmimit mes moshatarëve.



Grafiku 1. Përqindjet e nxënësve që janë ngacmuar të paktën 2-3 herë në muaj gjatë muajve të fundit

³ Kur flitet për dhunën të fëmijët dhe të rinjtë, termat "viktimë" dhe "dhunues" nuk ndihmojnë në kuptimin e plotë të dhunës dhe aq më pak në reagimin efektiv ndaj saj. Përkundrazi, ato 'ngjiten' te të rinjtë, duke i privuar ata nga mundësia për ndryshim dhe për tejkalimin e sfidave me të cilat përballen në zhvillimin e tyre. Me këtë mohohet edhe potenciali për ndryshim, i cili ndoshta është më i fortë pikërisht gjatë periudhës së adoleshencës. Për këtë arsye, termat "viktimë" dhe "dhunues" në këtë raport përdoren kushtimisht dhe jo si kategori të mbyllura dhe të pandryshueshme.

⁴ Dallim i rëndësishëm ($p < 0.05$)


Sa u përket llojeve të keqtrajtimit që përjetojnë nxënësit tanë (11-15 vjeç), më të shpeshta dhe më të ndjeshme janë përhapja e thashethemeve dhe shpifjeve (24%), ku 22% e djemve dhe 26% e vajzave kanë pasur përvoja të tilla në muajin e fundit. Në vendin e dytë (22%) është përdorimi i emrave fyes (D=21%; V=22%), ndërsa përjashtimin nga grupi janë ankuar 14% e djemve dhe 15% e vajzave. Një në 10 fëmijë (11%) ka përjetuar dhunë fizike (goditje, shtyrje), nga të cilët më shumë djem (14%) se vajza (9%) e kanë përjetuar të paktën 2-3 herë në muaj gjatë muajve të fundit gjegjësisht, një ndër 17 vajza (6%) e ka përjetuar të njëjtën situatë një ose dy herë gjatë muajit të fundit.

Nxënësit që kanë ngacmuar të tjerët në shkollë

Mesatarisht, 6% e fëmijëve nga mostra ndërkombëtare prej 44 vendeve kanë ngacmuar nxënës të tjerë në shkollë të paktën 2-3 herë në muaj gjatë muajve të fundit, ku djemtë janë më shpesh (8%) sesa vajzat (5%).

Në shkollat e Maqedonisë së Veriut, mesatarisht 9% e nxënësve kanë ngacmuar të tjerët të paktën 2-3 herë në muaj gjatë muajve të fundit, nga të cilët 10% janë djem dhe 7% vajza, që është mbi mesataren ndërkombëtare. Edhe këtu, përqindja e nxënësve që ngacmojnë të tjerët është më e lartë mes nxënësve nga bashkësia etnike shqiptare (11%), respektivisht në shkollat me gjuhë mësimore shqipe, në krahasim me shkollat me gjuhë mësimore maqedonase (8%).

Dallime të rëndësishme gjinore janë konstatuar te djemtë dhe vajzat 11 vjeçare⁵, ndërsa nuk është konstatuar ndonjë dallim i rëndësishëm sa i përket pasurisë familjare.



Grafiku 2. Përqindjet e nxënësve që kanë deklaruar se kanë ngacmuar të tjerë të paktën 2-3 herë në muaj gjatë muajve të fundit


⁵ Dallim i rëndësishëm ($p < 0.05$)

Nxënësit që kanë përjetuar ngacmim kibernetik

Mesataret ndërkombëtare nga Studimi HBSC-së në vitin 2022 (44 vende) zbulojnë se përafërsisht 1 në 6 nxënës (15%) kanë përjetuar ngacmim kibernetik, në mënyrë të barabartë mes djemve dhe vajzave, të paktën 1-2 herë gjatë muajve të fundit.

Nxënësit e moshës 11-15 vjeç në vendin tonë ndjekin këto trende, me 14% të djemve dhe 15% të vajzave që kanë raportuar ngacmim kibernetik. Në këtë drejtim, nga të gjithë grupet e të anketuarve, djemtë shqiptarë 11 vjeçar janë më shpesh të ekspozuar ndaj ngacmimeve kibernetike (21%).

Dallime të rëndësishme gjinore ka vetëm te fëmijët 11-vjeçarë⁶, ndërsa pasuria familjare nuk ka luajtur rol të rëndësishëm as në këtë lloj ngacmimi.



Grafiku 3. Përqindjet e nxënësve që kanë raportuar se kanë përjetuar ngacmime kibernetike të paktën 1-2 herë në muajt e fundit

Nxënësit që kanë marrë pjesë në ngacmim kibernetik


Në mostrën ndërkombëtare, 12% e djemve dhe 9% e vajzave kanë deklaruar se kanë ushtruar ngacmim kibernetik ndaj të tjerëve të paktën një ose dy herë gjatë muajve të fundit.

Në vendin tonë, 15% e djemve dhe 10% e vajzave kanë marrë pjesë në ngacmim kibernetik ndaj të tjerëve të paktën një ose dy herë gjatë muajve të fundit, ndërsa dallimet etnike janë të papërfillshme.

Dallime të rëndësishme gjinore në ngacmimin kibernetike janë konstatuar në të tri moshat⁷ mesatarisht, ku djemtë në të tri moshat më shpesh ushtrojnë ngacmim kibernetik se vajzat. Nuk ka dallime në sjelljen kibernetike të nxënësve të lidhur me pasurinë e familjes së tyre.

⁶ Dallim i rëndësishëm ($p < 0.05$)

⁷ Dallim i rëndësishëm ($p < 0.05$)



Grafiku 4. Përqindjet e nxënësve që kanë deklaruar se kanë marrë pjesë në ngacmime kibernetike të paktën 1-2 herë gjatë muajve të fundit

Nxënësit që kanë marrë pjesë në përlëshje

Mesatarisht, 10% e të rinjve (11-15 vjeç) nga 44 vende kanë raportuar se kanë marrë pjesë në përlëshje të paktën **tri herë gjatë 12 muajve të fundit**, me një dallim të rëndësishëm gjinore midis djemve (14%) dhe vajzave (6%).


Në të njëjtin drejtim sillen edhe mesataret kombëtare për të paktën tri përlëshje në vit (10%) të raportuara, me një dallim gjinor të ngjashëm, 13% mes djemve dhe 6% mes vajzave të moshës 11-15 vjeç.

Dallime të rëndësishme gjinore janë vërejtur në të gjitha grupmoshat dhe në të dy bashkësitë etnike, me përjashtim të nxënësve 11-vjeçarë në klasat me mësim në gjuhën shqipe.

Me rritjen e moshës, prevalenca e përlëshjeve midis nxënësve të paraleleve me mësim në gjuhën maqedonase (11-15 vjeç) bie, ndërsa te djemtë në paralelet shqipe, është në rritje.

Dallime etnike në pjesëmarrje në përlëshje vërehen te djemtë e moshës 11 dhe 15 vjeç, në drejtime të ndryshme. Përderisa në moshën 11 vjeçare, përlëshjet janë më të shpeshta midis nxënësve të paraleleve maqedonase (16%), në moshën 15 vjeç pasqyra ndryshon, me prevalencë më të lartë të përlëshjeve mes djemve shqiptarë (17%).

Djemtë nga familjet më të pasura (17%) marrin pjesë më shpesh në përlëshje se ata nga familjet më pak të pasura (14%).



Grafiku 5. Përqindjet e nxënësve që kanë marrë pjesë në përleshje të paktën 3 herë në 12 muajt e fundit

Nga ana tjetër, të paktën **një herë në vit** janë përleshur 20% e djemve, gjegjësisht 15% e vajzave (mesatarisht), ku edhe dallimet etnike janë të rëndësishme: 21% te nxënësit shqiptarë kundrejt 16% te nxënësit maqedonas.


Shkalla më e lartë e përleshjeve një herë në vit është vërejtur te djemtë shqiptarë të moshës 11 vjeç (26%) dhe 13 vjeç (24%), si dhe te djemtë maqedonas 13-vjeçarë (23%).

Gjetje për përvojat me dhunën ndaj fëmijëve

Në këtë pjesë paraqiten gjetjet për përvojat personale të nxënësve me dhunën ndaj tyre, si për ata që kanë deklaruar se kanë ngacmuar të tjerët, ashtu edhe për ata që nuk kanë ngacmuar.

Nxënësit që janë keqtrajtuar fizikisht


Më e madhe është përqindja e nxënësve që kanë përjetuar keqtrajtim fizik një ose dy herë gjatë jetës midis atyre që kanë raportuar se ngacmojnë bashkëmoshatarët e tjerë, krahasuar me ata që kanë thënë se nuk ngacmojnë. Përjashtim nga kjo bëjnë vajzat 15-vjeçare. Më shumë djem sesa vajza që kanë thënë se kanë ngacmuar të tjerët, kanë qenë të keqtrajtuar fizikisht një ose dy herë gjatë jetës. Dallimet më të mëdha janë te moshat 11 dhe 15 vjeç (28% djem kundrejt 20% vajza në moshën 11 vjeç; 29% djem kundrejt 17% vajza në moshën 15 vjeç).



Grafiku 6. Përqindjet e nxënësve që nuk ngacmojnë/ngacmojnë që janë keqtrajtuar fizikisht

Nxënësit që janë keqtrajtuar emocionalisht


Përqindja e nxënësve që kanë përjetuar keqtrajtim emocional një ose dy herë gjatë jetës është gjithashtu më e madhe mes atyre që kanë ngacmuar të tjerët, kundrejt atyre që kanë raportuar se nuk ngacmojnë, me përjashtim të vajzave 15-vjeçare. Midis tyre, më të prekurit janë djemtë (26%) dhe vajzat (25%) në moshën 11 vjeç, vajzat 13-vjeçare (26%) dhe djemtë 15-vjeçarë (22%).



Grafiku 7. Përqindjet e nxënësve që nuk ngacmojnë/ngacmojnë që janë keqtrajtuar emocionalisht

Nxënësit që janë keqtrajtuar seksualisht


Nxënësit që kanë raportuar se kanë ngacmuar janë më shpesh viktimat të abuzimit seksual, me prekje dhe përkëdhelje, krahasuar me bashkëmoshatarët e tyre që nuk kanë ngacmuar. Kjo gjetje vlen për të dy gjinitë në të tri moshat. Veçanërisht të prekura janë vajzat 15-vjeçare.



Grafiku 8. Përqindjet e nxënësve që janë abuzuar seksualisht

Nxënësit që kanë qenë dëshmitarë të dhunës në familje

Dallime të rëndësishme janë vërejtur edhe në përvojat e të qenit dëshmitar të dhunës në familje midis nxënësve që kanë raportuar se kanë ngacmuar bashkëmoshatarët dhe atyre që nuk kanë ngacmuar, me përjashtim të vajzave 15-vjeçare. Të paktën një në dhjetë fëmijë që kanë thënë se kanë ngacmuar të tjerët kanë qenë dëshmitarë të dhunës në familje një ose dy herë gjatë jetës së tyre. Midis tyre, më të shumtë në numër janë djemtë 11-vjeçarë (19%) dhe vajzat 13-vjeçare (15%).



Grafiku 9. Përqindjet e nxënësve që nuk ngacmojnë/ngacmojnë që kanë qenë dëshmitarë të dhunës në familje



Tendencat themelore

Dallimet gjinore

Në përgjithësi, sipas të dhënave nga viti 2022, dallimet gjinore në shumicën e indikatorëve të dhunës të hulumtuar janë të rëndësishme. Në rolin e viktimave më shpesh paraqiten vajzat, me përjashtim të djemve njëmbëdhjetëvjeçarë, të cilët janë dukshëm më të përfshirë në të gjitha format e dhunës ndërmjet bashkëmoshatarëve, edhe si kryerës ashtu edhe si viktima.

Dallime të rëndësishme gjinore në të tri moshat janë vërejtur edhe te të rinjtë që kanë deklaruar se kanë kryer ngacmime kibernetike dhe kanë marrë pjesë në përleshje. Në të dy rastet, djemtë janë më të përfshirë në këto forma të dhunës sesa vajzat.

Ndikimi i moshës


Mosha ndikon ndryshe në sjelljet dhe përvojat e dhunshme te djemtë dhe vajzat. Përderisa me rritjen e moshës bie përqindja e djemve që janë ngacmuar, te vajzat viktimizimi është më i theksuar në moshën 13 vjeç. Nëse analizohen edhe në nëngrupe etnike, më të cënueshëm janë djemtë dhe vajzat njëmbëdhjetëvjeçare nga paralelet shqiptare. Me moshën bie edhe përqindja e djemve që ngacmojnë të tjerët, ndërsa te vajzat ky trend është relativisht i qëndrueshëm.

Sa i përket ngacmimit kibernetik, me kalimin e moshës, vajzat janë më shpesh viktima, në krahasim me djemtë. Me kalimin e moshës, djemtë dhe vajzat nga bashkësia maqedonase janë më të përfshirë në ngacmimet kibernetike ndaj moshatarëve, në krahasim me nxënësit nga paralelet shqiptare.

Me kalimin e moshës, rritet edhe numri i djemve nga bashkësia etnike shqiptare që përfshihen në përleshje, ndërsa te vajzat shqiptare, si dhe tek djemtë dhe vajzat maqedonase, prevalenca e përfshirjes në përleshje bie me kalimin e moshës.


Ndryshimet me kalimin e kohës – para dhe pas Kovid-it

Në vitin 2022, pas pandemisë së KOVID-19, rritet numri i djemve dhe vajzave të të gjitha moshave që raportojnë se janë ngacmuar në shkollë të paktën 2 ose 3 herë në muajt e fundit. Rritja më e madhe në krahasim me vitin 2018, para pandemisë së KOVID-19, është vërejtur në përqindjet e djemve dhe vajzave njëmbëdhjetëvjeçare (D: 9% në 2018 dhe 14% në 2022; V: 5% në 2018 dhe 11% në 2022).




Grafiku 10. Përqindjet e nxënësve që janë ngacmuar në shkollë të paktën 2 ose 3 herë në muajt e fundit, para dhe pas Kovid-it

Në vitin 2022 (pas KOVID-it) rritet numri i djemve dhe vajzave njëmbëdhjetëvjeçare (D: 8% në 2018 dhe 12% në 2022; V: 3% në 2018 dhe 8% në 2022) dhe vajzave 15 vjeçare që kanë marrë pjesë në ngacmimin e nxënësve të tjerë në shkollë të paktën 2 ose 3 herë në muajt e fundit, ndërsa bie te djemtë pesëmbëdhjetëvjeçarë (V: 5% në 2018 dhe 7% në 2022; D: 10% në 2018 dhe 9% në 2022).




Grafiku 11. Përqindjet e nxënësve që ngacmuan nxënësit/tjerë në shkollë të paktën 2 ose 3 herë në muajt e fundit, para dhe pas Kovid-it

Rritja e numrit të nxënësve që kanë raportuar se janë ngacmuar në mënyrë kibernetike të paktën një herë në muajt e fundit është e dukshme te të dy gjinitë dhe të gjitha moshat në periudhën pas pandemisë së KOVID-19, për 4-7 përqindësh.




Grafiku 12. Përqindjet e nxënësve që përjetuan ngacmim kibernetik të paktën një herë në muajt e fundit, para dhe pas Kovid-it

Në vitin 2022 (pas Kovidit), përqindja rritet (për 5-6 përqindësh) e djemve dhe vajzave që raportojnë se kanë marrë pjesë në ngacmim kibernetik të paktën një herë në muajt e fundit.



Grafiku 13. Përqindjet e nxënësve që kanë marrë pjesë në ngacmim kibernetik të paktën një herë në muajt e fundit, para dhe pas Kovid-it

Në vitin 2022, rritet edhe numri i djemve dhe vajzave që kanë marrë pjesë në një përleshje të paktën tre herë në 12 muajt e fundit, krahasuar me vitin 2018. Rritja, prej 4-5 përqindësh, është më e dukshme te vajzat dhe djemtë njëmbëdhjetëvjeçarë.



Grafiku 14. Përqindjet e nxënësve që kanë marrë pjesë në një përleshje të paktën tre herë në 12 muajt e fundit, para dhe pas Kovid

Përfundime

Hulumtimi në suaza të Studimit HBSC për vitin 2021/22 ofron njohuri të rëndësishme mbi dhunën ndërmjet bashkëmoshatarëve në vendin tonë, duke i parë në krahasim me vendet e tjera pjesëmarrëse në studim, si dhe para dhe pas pandemisë së KOVID-19, nga dimensionet gjinore dhe të moshës. Për më tepër, ky hulumtim informon mbi përvojat e fëmijëve që mund të ndikojnë në sjelljen e dhunshme, me çka ofron një bazë të fortë për krijimin e politikave dhe veprimeve për parandalimin e dhunës.

Dhuna ndërmjet bashkëmoshatarëve në vendin tonë është një çështje shqetësuese që prek seriozisht shëndetin dhe mirëqenien e të rinjve dhe fëmijëve. Kjo dhunë është e pranishme si te djemtë ashtu edhe te vajzat, pavarësisht nga statusi socio-ekonomik i familjeve të tyre, me përjashtim të djemve nga familjet më të pasura, të cilët marrin pjesë më shpesh në përleshje sesa ata nga familjet më pak të pasura.

Në krahasim me mesataret ndërkombëtare, në Maqedoninë e Veriut është më e lartë përqindja e nxënësve që përfshihen në ngacmimin e bashkëmoshatarëve, qoftë në jetën reale ose online. Përqindjet e “viktimize” të ngacmimit dhe të ngacmimit kibernetik, si dhe pjesëmarrja në përleshje, ndjekin mesataret ndërkombëtare.

Dallimet janë më të dukshme në dimensionin e moshës, duke zbuluar cenueshmërinë e veçantë të djemve njëmbëdhjetëvjeçarë në të gjitha format e dhunës ndërmjet bashkëmoshatarëve, siç janë përleshjet, ngacmimi dhe ngacmimi kibernetik. Ata më së shpeshti janë edhe në rolin e “viktimize” edhe në rolin e “dhunuesve” në të tri format e dhunës.

Me kalimin e moshës, mesatarisht, sjellja e dhunshme midis nxënësve nga 11 deri në 15 vjeç në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka tendencë të ulet, me një shkallë dukshëm më të lartë tek djemtë njëmbëdhjetëvjeçarë, veçanërisht nga paralelet shqiptare. Ndryshe nga ngacmimi, mosha nuk luan një rol të rëndësishëm në ngacmimin kibernetik, i cili ka tendencë të mbetet i lartë në të gjitha moshat, ose të rritet, te djemtë dhe vajzat maqedonase. Nga ana tjetër, pjesëmarrja në përleshje rritet me moshën te djemtë shqiptarë, ndërsa te nxënësit nga paralelet maqedonase bie.

Rolin gjinore vazhdojnë të formësojnë sjelljet e djemve dhe vajzave, kështu që edhe në këtë studim tregohet se vajzat në të tri moshat marrin pjesë dy herë më pak në përleshje në krahasim me djemtë, ndërsa edhe në ngacmimin kibernetik angazhohen më pak.

Dallimet etnike në sjelljen e dhunshme të nxënësve nga shkollat me mësim në gjuhën maqedonase kundrejt atyre me mësim në gjuhën shqipe janë më të rëndësishme në format tradicionale të dhunës (ngacmimi dhe përleshjet), ku vajzat dhe fëmijët më të vegjlit (djemtë dhe vajzat njëmbëdhjetëvjeçarë) janë më të prekur, në krahasim me dhunën online, ku edhe vajzat maqedonase me kalimin e moshës bëhen viktima gjithnjë e më shpesh.

Krahasimet e gjetjeve nga periudha para dhe pas pandemisë KOVID-19 (2018-2022) tregojnë një rritje të rëndësishme të prevalencës së të gjitha formave të dhunës ndërmjet nxënësve në periudhën pas pandemisë.

Gjetjet tregojnë gjithashtu se fëmijët që janë të dhunshëm dhe kanë ngacmuar janë grup me rrezik të lartë për zhvillimin dhe mirëqenien e tyre, si dhe për të gjithë bashkësinë. Shëndeti i tyre mendor dhe mirëqenia e përgjithshme janë seriozisht të rrezikuara. Prapa sjelljes së tyre të padëshiruar qëndron ndikimi i përvojave traumatike, me përgjigje të dobëta, kapacitete të papërdorura për përballim, si dhe mbështetja gjithnjë e më e ulët nga të rriturit e rëndësishëm dhe bashkëmoshatarët.

Rekomandime

Për një qasje efektive në trajtimin dhe parandalimin e dhunës ndërmjet bashkëmoshatarëve, është e nevojshme të angazhohen institucionet dhe e gjithë bashkësia. Ndërhyrjet duhet të bazohen në dëshmi dhe të zbatohen përmes qasjeve gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj nevojave dhe të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve. Ato duhet të sigurojnë qasje të barabartë dhe efektivitet për të gjithë të rinjtë, pavarësisht nga statusi i tyre socio-ekonomik, gjinia, ose çfarëdo lloj tjetër përkatësie.

Për efikasitet dhe qëndrueshmëri të ndërhyrjeve, ndjekja dhe hulumtimi i vazhdueshëm janë veçanërisht të rëndësishëm për ta kuptuar më mirë natyrën evolutive të dhunës ndërmjet bashkëmoshatarëve, sidomos në epokën e mediave digjitale dhe normave sociale që ndryshojnë shpejt.

Ndërhyrjet për parandalimin e dhunës duhet të bazohen në **faktorët mbrojtës** të njohur, siç janë: kompetencat personale të orientuara drejt vetes (pro-socialiteti, vetëvlerësimi, empatia), që janë treguar si faktori më i fortë mbrojtës ndaj viktimizimit; përdorimi i ulët i teknologjisë parandalon përfshirjen në ngacmimet kibernetike; suksesi akademik dhe kompetencat sociale të orientuara drejt të tjerëve janë faktorët më të fortë mbrojtës ndaj ngacmimeve, ndërsa ndërveprimet pozitive me bashkëmoshatarët janë faktori më i fortë mbrojtës si për ngacmimet ashtu edhe për viktimizimin (15).

Rekomandimi më urgjent për institucionet arsimore është të kërkojnë mbështetje profesionale dhe financiare për të vendosur një **qasje** gjithëpërfshirëse **në tërë shkollën** (11), ku do të punohet për parandalimin dhe ndërhyrjen e hershme në më shumë nivele, me përfshirjen adekuate të nxënësve, mësimitdhënësve, shërbimit profesional, udhëheqësisë së shkollës, prindërve dhe komunës. Në radhë të parë janë mësimitdhënësit, të cilët duhet të inkurajohen dhe mbështeten përmes trajnimeve të përshtatshme për qasjet e informuara për traumë (14). Në kontakt të drejtpërdrejtë me fëmijët, çdo ditë, ata janë të parët që mund të vërejnë dhe njohin shenjat e çdo forme të vuajtjes dhe dhunës, për t'i mbështetur në mënyrë të përshtatshme nxënësit që janë të përfshirë si "viktima" ose "kryerës të dhunës". Paralelisht, duhet të ndërtohen kapacitetet e personelit tjetër të shkollës, si dhe të prindërve, në mënyrë që secili, nga pozita e tij e përgjegjësisë, t'i mbështesë fëmijët, sidomos kur janë në hall.

Fëmijët dhe të rinjtë duhet të kenë në dispozicion **sisteme efektive mbështetjeje në shkollë dhe në bashkësi**, të cilat mund të sigurojnë ndihmë të menjëhershme dhe mbështetje psikologjike për të rinjtë më të prekur, si për shembull sigurimin e pranisë së të rriturve gjatë pushimeve, forcimin e kompetencave ndërpersonale të mësuesve, shërbimit profesional dhe prindërve, siç janë empatia, respektimi i individualitetit, aftësia për të ndryshuar perspektivën dhe interesimi për fëmijën dhe potencialet e tij. Të rinjtë duhet të mbështeten gjithashtu në aspekt të informimit për të njohur format e ndryshme të ngacmimit kibernetik, si formë dhune që është në rritje.

Është e nevojshme të bëhet një **shqyrtim dhe forcim i politikave ekzistuese për parandalimin e dhunës** brenda institucioneve arsimore dhe platformave online. Në përputhje me to, duhet të kryhen revizione të politikave të shkollave në drejtim të përfshirjes së masave gjithëpërfshirëse dhe protokolleve për përmirësimin e sigurisë së nxënësve në shkollë, në bashkësi dhe në hapësirën online.

Parandalimi i dhunës ndërmjet bashkëmoshatarëve duhet të zërë një vend të rëndësishëm edhe në **programet për përmirësimin e shëndetit mendor të nxënësve**, pasi ndërhyrja dhe mbështetja e hershme mund të parandalojnë rezultatet negative, si ankthi, depresioni, vetëvlerësimi i ulët dhe mungesa e besimit në vetvete.

Kultura pa dhunë duhet të kultivohet në shkolla në mënyrë të qëndrueshme, të vazhdueshme dhe sistematike, përmes modelimit të komunikimit jo të dhunshëm ndërmjet të rriturve dhe nga ata tek fëmijët. Ndërtimi i një kulture të respektit, kujdesit dhe solidaritetit midis nxënësve mund të zvogëlojë ndjeshëm prevalencën e dhunës ndërmjet bashkëmoshatarëve. Kjo nënkupton iniciativa të qëndrueshme arsimore, përfshirjen e bashkësisë dhe modeleve pozitive midis të rriturve dhe autoriteteve që kanë ndikim te të rinjtë.

Është e nevojshme të investohet në **mbështetjen e nxënësve për arritjet akademike**, të cilat janë faktor mbrojtës nga përfshirja në ngacmime të të tjerëve. Strategjitë afatgjata për ndërtimin e mjediseve arsimore të sigurta dhe gjithëpërfshirëse janë jetike për suksesin akademik dhe rritjen e zhvillimin personal të çdo nxënësi.

Për fund, më e rëndësishmja është **të dëgjohet zëri i fëmijëve dhe të rinjve**, duke filluar nga përvojat e tyre si viktimë të dhunës, sfidat me të cilat përballen në familje dhe në shkollë, nevojat e tyre, si dhe propozimet e tyre për trajtimin e dhunës. Duhet të theksohet rëndësia e empatisë dhe e të kuptuarit të përvojave të ngacmimit të të rinjtë, si ata që e kryejnë dhunën, ashtu edhe ata që e vuajnë atë, duke nënvizuar rëndësinë e krijimit të mjediseve mbështetëse dhe rolin e tyre në përmirësimin e mirëqenies së të rinjve.

Shembuj të praktikave të mira për parandalimin e dhunës ndërmjet bashkëmoshatarëve

Shembull nga vendi ynë

Shoqata qytetare “Rubikon” ka 25 vite që praktikon teknikën teatrore të Teatrit Forum në edukimin e rregullt joformal⁸. Kjo teknikë mundëson shprehjen e hapur të nevojave dhe problemeve, zbulon temat tabu dhe në mënyrë konstruktive mbështet ballafaqimin me sfidat. Publiku nuk është vëzhgues pasiv, por merr pjesë aktive në skenë për të gjetur zgjidhje të ndryshme për situatat problematike që trajtohen përmes etydeve të shkurtra. Një nga qëllimet e kësaj teknike teatrore është nxitja e përgjegjësisë individuale dhe proaktivitetit—nxitja e veprimit në vend të vëzhgimit pasiv. Pjesëmarrja në skenë dhe diskutimet në publik ofrojnë ngritjen e vetëbesimit, mësimin e aftësive sociale dhe motivimin për të dalë nga zona e rehatisë me qëllim ndikimin pozitiv në mjedisin përreth.

Shoqata ka përvojë të pasur në zbatimin e projekteve afatgjata për trajtimin e dhunës në institucionet arsimore. Përvoja e tyre përfshin punën me nxënësit, mësimdhënësit, shërbimin profesional, drejtuesit e shkollave dhe dëshmon për ngritjen e ndërgjegjësisë dhe reduktimin e praktikave të dhunës në bashkësitë me të cilat punojnë.

Shembuj nga vende të tjera

Programi Olweus

Programi shkollor për parandalimin e ngacmimit Olweus⁹, është dizajnuar në mënyrë gjithëpërfshirëse me qëllim të parandalimit ose zvogëlimit të ngacmimit në shkollat fillore dhe të mesme (nxënës nga 6 deri në 15 vjeç). Përfshin të gjithë shkollën dhe bashkësinë, duke ristrukturuar mjedisin ekzistues shkollor nën udhëheqjen e personelit shkollor. Qëllimet e programit janë të zvogëlojë dhe parandalojë dhunën ndërmjet bashkëmoshatarëve, të përmirësojë marrëdhëniet midis tyre dhe ta bëjë shkollën vend të sigurt dhe pozitiv për mësim dhe zhvillimin e nxënësve. Programi përfshin edhe viktimat e ngacmimeve dhe ata që ngacmojnë, si dhe mësuesit dhe prindërit/kujdestarët e tyre. Zbatohet në shumë vende të botës, ndërsa në SHBA është i pranishëm në mijëra shkolla. Njëkohësisht, programi përfshin një hulumtim ndërkombëtar longitudinal që tregon reduktim të dhunës ndërmjet bashkëmoshatarëve, përmirësimin e klimës sociale në klasa dhe uljen e sjelljeve antisociale shoqëruar si vandalizmi dhe mungesat e pajustifikuara nga shkolla.

Programi KiVa

Programi KiVa¹⁰ është zhvilluar nga Universiteti në Turku, Finlandë dhe është një nga programet më të njohura kundër ngacmimeve në mbarë botën, i fokusuar në parandalim dhe ndërhyrje. Ai përfshin mësim për emocionet, dinamikën e grupit dhe strategjitë kundër ngacmimeve. Gjithashtu,

8 <https://www.facebook.com/profile.php?id=100069617085562>

9 <http://www.mentalhealthpromotion.net/resources/theolweusbullyingpreventionprogram.pdf>

10 <https://data.kivaprogram.net/>

ka vegla për mësuesit që të identifikojnë dhe të ndërhyjnë në situata të ngacmimit. Karakteristikat kryesore që e dallojnë programin janë ofrimi i mësimeve të strukturuar për nxënësit për empati, respekt dhe sjellje në grup, pastaj mbështetja dhe monitorimi sistematik, si dhe mjete online dhe materialet edhe për nxënësit edhe për mësuesit. Hulumtimet mbi ndikimin e KiVa-s tregojnë ulje të konsiderueshme të ngacmimeve në shkollat në Finlandë. Pas rezultateve të treguara, programi është miratuar edhe në vende të tjera, përfshirë Estoninë dhe Italinë.

Literatura e përdorur

1. Krug EG, Mercy JA, Dahlberg LL, Zwi AB. The world report on violence and health. Lancet. 2002; [https://www.thelancet.com/journals/lancet/article/PIIS0140-6736\(02\)11133-0/abstract](https://www.thelancet.com/journals/lancet/article/PIIS0140-6736(02)11133-0/abstract) (пристапено на 22.09.2024)
2. Keeping the Promise: Ending Violence against Children by 2030, July 2019, United Nations. https://violenceagainstchildren.un.org/sites/violenceagainstchildren.un.org/files/keeping_the_promise.pdf (пристапено на 22.09.2024)
3. Истражување за знаењата, ставовите, практиките и социјалните норми на родителите и старателите во врска со насилните форми на дисциплинирање деца, УНИЦЕФ (2017) Скопје https://www.unicef.org/northmacedonia/media/4241/file/MK_KAPonVAC_Report_MK.pdf (пристапено на 22.09.2024)
4. БИРН, Кевин, Анализа на состојбата на жените и децата во Република Северна Македонија [Електронски извор]: извршно резиме / Кевин Бирн. – Скопје : Канцеларија на УНИЦЕФ, 2020 [https://www.unicef.org/northmacedonia/mk/media/8716/file/%D0%95xecutive%20summary:%20An%20analysis%20of%20the%20situation%20of%20women%20and%20children%20\(MKD\).pdf](https://www.unicef.org/northmacedonia/mk/media/8716/file/%D0%95xecutive%20summary:%20An%20analysis%20of%20the%20situation%20of%20women%20and%20children%20(MKD).pdf) (пристапено на 22.09.2024)
5. Violence against Children, United Nations Secretary-General's Study, 2006. https://violenceagainstchildren.un.org/sites/violenceagainstchildren.un.org/files/document_files/world_report_on_violence_against_children.pdf (пристапено на 22.09.2024)
6. Cosma, Alina, Molcho, Michal & Pickett, William. (2024). A focus on adolescent peer violence and bullying in Europe, central Asia and Canada. Health Behaviour in School-aged Children international report from the 2021/2022 survey. World Health Organization. Regional Office for Europe. <https://iris.who.int/handle/10665/376323> (пристапено на 22.09.2024)
7. Cvetanoska M, Hristov I, Kostarova-Unkovska L & Osmani-Balazhi S (2024) Violence and Powerlessness – A Look at Vulnerability and Overcoming. Unpublished paper, presented at the International Conference: 50 years Institute of Psychology at the University Ss. Cyril and Methodius, Skopje
8. Erikson, E. H. (1980). *Identity and the life cycle*. W W Norton & Co.
9. Училиште по мерка на детето, експертска група МОН и УНИЦЕФ, 2006
10. Craig, W. M., & Pepler, D. J. (1997). Observations of bullying and victimization in the school yard. *Canadian Journal of School Psychology*, 13(2), 41-59. <https://doi.org/10.1177/082957359801300205> (пристапено на 23.09.2024)
11. Olweus, D. (1997). Bully/victim problems in school: Facts and intervention. *European Journal of Psychology of Education*, 12(4), 495-510. <https://doi.org/10.1007/BF03172807> (пристапено на 23.09.2024)

12. Olweus, D. (1996). The Revised Olweus Bully/Victim Questionnaire. Bergen, Norway: Research Center for Health Promotion (HEMIL Center), University of Bergen.
13. Schoffstall, C., & Cohen, R. (2011). Cyber aggression: The relation between online offenders and offline social competence. *Social Development*, 20 (3), 587-604. <https://doi.org/10.1111/j.1467-9507.2011.00609.x> (пристапено на 23.09.2024)
14. Valgiusti F. (2022) Trauma informed approach, An introductory Handbook. Retrieved on 1 July 2024 from: <https://www.unicef.org/northmacedonia/reports/trauma-informed-approach>
15. Zych, I., Ortega-Ruiz, R., & Del Rey, R. (2019). Scientific research on bullying and cyberbullying: Where have we been and where are we going?. *Aggression and Violent Behavior*, 45, 1-10.

Hulumtimi kombëtar në vitin 2021/2022 u realizua nga Qendra për Aksion Psiko-Social dhe të Krizës - Malinska dhe ekipi kombëtar i Studimit HBSC, nën drejtimin e Hulumtueses kryesore për Republikën e Maqedonisë së Veriut, Lina Qostarova Unkovska dhe ekipit kombëtar të përbërë nga: Sheruze Osmani Balazhi, Universiteti i Tetovës; Kalina Sotiroska Ivanoska, Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi”; Maja Cvetanoska, Qendra për hulumtim, arsimim dhe zhvillim - RED Qendra; Luljeta Bexheti, Universiteti i Tetovës; Ibrahim Neziri, Universiteti i Tetovës; Ana Poprizova, SHMQSH “Orce Nikolov”, Shkup dhe Ivan Hristov, Qendra për hulumtim, arsimim dhe zhvillim - RED Qendra.

Qendra për veprim psiko-social dhe të krizës -Malinska
bul. Partizanski Odredi 23-1/3
02 3298238
<https://cpka.mk>
<https://hbscmacedonia.wordpress.com/>
<http://www.hbsc.org/>



